

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS
E MBAJTUR MË 14 MARS 2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 14. MARTA 2007. GODINE

Mars – Mart
2007

RENDI I DITËS

- 1. Njoftim mbi rrjedhën e bisedimeve përfundimtare të mbajtura me datën 10 mars 2007 në Vjenë
(Raporton Grupi i Unitetit)**

DNEVNI RED

- 1. Obaveštenje o toku završnih pregovora održanih dana 10. marta 2007. godine u Beču
(Izveštava Grupa uniteta).**

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju lutem do ta fillojmë seancën e sotme. Në sallë kemi 94 deputetë. E kemi një pikë të rendit të ditës të cilën e keni marrë më herët - Njoftimi mbi rrjedhën e bisedimeve përfundimtare të mbajtura më 10 mars 2007 në Vjenë.

Kemi me ne sot edhe një pjesë, jo të tërën, të Grupit Negociator të Kosovës, dy prej tyre janë në udhëtim zyrtar jashtë Kosovës.

Pra, zotëri President i Kosovës Fatmir Sejdiu, zotëri Kryeministër i Kosovës Agim Çeku, zotëri anëtar i Grupit Negociator, Hashim Thaçi, zotërinj ministra të Qeverisë së Kosovës, kolegë deputetë të çmuar e të nderuar.

Për fillim të kësaj seance fjalën e merr kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu, i cili është njëkohësisht edhe udhëheqës i Grupit Negociator.

PRESIDENTI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU – I nderuari kryesues i seancës z. Hamiti, i nderuari Kryeministër dhe ministra të Qeverisë së Kosovës, të nderuar deputetë.

Siç jeni njoftuar të shtunën e kaluar më 10 mars 2007 përfunduan bisedimet në Vjenë lidhur me çështjet e veçanta që kanë të bëjnë edhe me statusin e Kosovës, nën udhëheqjen e presidentit Ahtisari.

Ky ishte takimi i fundit në nivelin më të lartë përfaqësues të vendeve. Ishte ky një proces i gjatë dhe i vështirë që zgjati rreth 14 muaj. Delegacioni i Kosovës e ka informuar këtë Kuvend në vazhdimësi lidhur me bisedimet duke pasur mbështetjen e tij të njëkohshme. Po kështu, para konsultimeve shtesë që u mbajtën para tatimit të fundit në Vjenë, në këtë Kuvend u zhvillua një debat i gjerë dhe i rëndësishëm lidhur me propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari, ose, siç jemi mësuar ta quajmë Pakon e Ahtisarit.

Delegacioni i Kosovës përmes delegacioneve të tij, si më parë ashtu edhe së fundi në konsultimet shtesë që zhvilluan nga fundi i shkurtit dhe ditët e para të marsit 2007, ka shtruar edhe një herë qëndrimet e tij lidhur me këtë propozim, që si të tilla janë ndërtuar duke pasur parasysh, pos tjerash edhe vërejtjet dhe shqetësimet e paraqitura në Kuvend dhe të njëjtën kohë edhe nga institucionet e tjera dhe qytetarët. Duke pasur parasysh faktin se Pakoja e presidentit të Ahtisarit e përmbyllur tani në strukturën e saj të tërësishme, krahas elementeve të tjera që i trajton për pozitën e komuniteteve pakicë në Kosovë, ajo si e tillë përmban bazë themelore dhe të qëndrueshme për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës, si dhe duke pasur parasysh edhe mbështetjen e Kuvendit të Kosovës, ne i kemi pranuar në parim si të tillë.

Serbët dhe pakicat e tjera në Kosovë në këtë pako të statusit të Kosovës marrin të drejta dhe garanca që sigurojnë përfaqësimin e tyre politik, ose them më saktë dhe mbi përfaqësimin politik, por edhe të drejta vetëqeverisjeje në rrafshin lokal që pakicat e tjera në këtë pjesë të Evropës mund t'ua kenë lakmi.

Krejt kjo është bërë sepse kemi dashur t' jua garantojmë këto të drejta, sepse ne duam të ndërtojmë fatin dhe mirëqenien tonë mbi lumturinë tonë e të bashkëqytetarëve tanë, mbi lumturinë e përbashkët e jo mbi fatkeqësinë e kujtdo.

Në takimin e fundit të Vjenës, duke ofruar argumentet tona për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës, kemi theksuar fuqishëm, si edhe më parë, se pavarësia e Kosovës është alfa dhe omega, fillimi dhe mbarimi i qëndrimit tonë. Asnjë lidhje strukturore me institucionet e Serbisë nuk është e pranueshme për ne.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të ju them se Delegacioni i Kosovës në unitet të plotë ka shprehur qëndrimin e vet për këtë proces që duhet të përmbyllet tani me njohjen e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.

Ne kemi shprehur besimin tonë të plotë në presidentin Ahtisari dhe ekipin e tij, për Grupin e Kontaktit, Unionin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-në për përkushtimin e tyre për përmbylljen e këtij procesi sa më shpejtë. Përkushtimin e veçantë të presidentit Ahtisari për këtë e dëshmon fakti se propozimi i tij bashkë me rekomandimet politike për të ardhmen e Kosovës ai i ka transmetuar që sot në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara duke kushtuar peshë të veçantë propozimit të tij si tërësi bashkë me rekomandimet politike dhe trajtimin të Kosovës si rast sui generis në veçanti.

Delegacioni i Kosovës ,duke shprehur qëndrimin e tij për këtë dokument si të pranueshëm për Kosovën dhe duke pasur parasysh edhe plotësimet e ndërkohshme që i ka bërë presidenti Ahtisari, e që kanë qenë të njohura për ne, në të cilat si të tilla nuk e prishin substancën e dokumentit, që besoj si tërësi do ta ketë Kuvendi i Kosovës në një të ardhme të afërt, ka shprehur përkushtimin e tij se Kosova do të angazhohet denjësisht për implementimin e marrëveshjes që nënkupton pavarësimin e saj ,në radhë të parë duke kërkuar efikasitet të institucioneve në zbatimin e saj.

Delegacioni i Kosovës, po kështu, ka shprehur qëndrimin e tij se Kosova do të angazhohet që kjo marrëveshje të ketë refleksionin e saj të drejtpërdrejtë në Kushtetutën e Kosovës dhe në ligjet e tjera që kanë të bëjnë me këtë materie.

Të nderuar deputetë,

Delegacioni i Kosovës, po kështu, ka shprehur qëndrimin e tij për të mirëpritur një prezencë të re civile ndërkombëtare në Kosovë dhe vazhdimin e prezencës së trupave të NATO-së në Kosovë. Këto i konsiderojmë si faktorë të rëndësishëm për të ndihmuar Kosovën për zhvillimet më të shpejta dhe për integrimin e saj në strukturat Evropiane, pra edhe në anëtarësimin e Kosovës në Unionin Evropian dhe në NATO. Kjo njëkohësisht do të thotë një ndihmë e veçantë për shtimin e efikasitetit të institucioneve të Kosovës në fushën e sundimit të ligjit dhe të sigurisë dhe për ngritjen e një force mbrojtëse të Kosovës të përputhshme me standardet e NATO-së.

Delegacioni i Kosovës me theks të veçantë e ka shprehur qëndrimin dhe gatishmërinë e Kosovës që të jetë pjesë e anëtarësuar e sistemit ndërkombëtar, përkatësisht në mekanizmat ndërkombëtar deri në anëtarësimin e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Të nderuar deputetë,

Duke pritur dhe besuar se ky proces do të përfundojë shpejtë në nivelin më të lartë të vendimmarrjes në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke hequr nga fuqia Rezolutën 1244 dhe duke nxjerrë Rezolutë të re për të ardhmen e Kosovës, më lejoni që edhe një herë të përshëndes nga këtu presidentin Ahtisari, Grupin e Kontaktit, NATO-n, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Unionin Evropian dhe Unosekun për angazhimin e tyre objektiv për kurorëzimin e këtij procesi në definimin e statusit politik të vendit tonë.

Kosova de fakto e pavarur nga viti 1999, falë rezistencës së saj të gjatë, duke u mbështetur në për degëzimet e luftës sonë politike dhe të armatosur që identifikon me presidentin Ibrahim Rugova, udhëheqjen e lëvizjes independente që do të shihet në retrospektivën historike si themelart i shtetit të Kosovës dhe Adem Jasharin, komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe falë intervenimit të NATO-së sot e pret njohjen e saj ndërkombëtare si kusht sin enkuano për ekzistencën e saj dhe hapjen e perspektivës së re demokratike dhe zhvillimore dhe për bërjen e saj faktor të rëndësishëm për stabilitetin rajonal dhe më gjerë. Qasja jonë është cilësia e mirë dhe bashkëpunimi me gjithë fqinjët tanë, ne do të dëshmojemi. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Falënderojmë Presidentin e Kosovës Fatmir Sejdiu. Fjalën e merr Kryeministri i Kosovës z. Agim Çeku.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS AGIM ÇEKU – I nderuari z. President i Kosovës, z. Thaçi, i nderuari kryesues i seancës z. Hamiti, të nderuar deputetë të nderuar ministra.

Kam, gjithashtu, kënaqësinë e veçantë që mu dha rasti që sot të jem pjesë e informimit të këtij Parlamenti të nderuar për ecurinë e procesit të bisedimeve për statusin e Kosovës. Siç tha edhe presidenti dhe siç jemi edhe dëshmitarë gjithë, takimi i së shtunës përmbylli procesin e bisedimeve për statusin e Kosovës dhe ky proces u përmbyll me sukses, sepse e konsiderojmë sukses propozimin e Ahtisarit që në vete përmban shtetësinë e Kosovës, i cili propozon shumë qartë pavarësi për Kosovën dhe sovranitet të qytetarëve të Kosovës mbi Kosovën.

Pjesë e këtij sukseksi konsiderojmë se jemi të gjithë në radhë të parë qytetarët e Kosovës, i gjithë spektri politik i Kosovës, ky Parlament, Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera të Kosovës.

Më lejoni të flas pak edhe për rolin e Qeverisë së Kosovës në këtë proces.

Qeveria e Kosovës ka qenë shumë aktive, shumë konstruktive në këtë proces. Në radhë të parë duke kontribuar në ruajtjen e unitetit, duke kontribuar në gjetjen e zgjidhjeve më të mira, propozimeve më të mira më të pranueshme në procesin e bisedimeve, por edhe duke prodhuar argumente konkrete që e mbështesin pavarësinë e Kosovës, që e mbështesin kërkesën tonë për pavarësi të Kosovës. Kështu që ne kemi kontribuar me punën tonë po them, po ndalem te Qeveria, por edhe gjithë ne, populli, Parlamenti kemi kontribuar që ta bindim faktorin ndërkombëtar që Kosova është gati të jetë shtet, të veprojë si shtet dhe është gati t'i marrë përgjegjësitë e shtetit mbi veti ta administrojë, ta qeverisë vetveten.

Kështu që gjithmonë kemi qenë të monitoruar nga bashkësia ndërkombëtare se sa jemi duke përparuar, sa jemi duke ngritur dhe ndërtuar kapacitetet tona dhe sa jemi të gatshëm ta marrim barrën e shtetësisë mbi vete.

Kemi pasur shumë sfida para veti, kemi pas standardet për Kosovën, i dimë tetë, mandej kemi pas 13 pika të Grupit të Kontaktit, kemi pasur Planin e veprimit të partneritetit evropian, kemi pasur kërkesat e vazhdueshme që të punojmë në integrimin e minoriteteve, në ndërtimin e mirëbesimit mes komuniteteve, në ndërtimin e besimit të qytetarëve në institucionet e Kosovës, qeverisjen Kosovës dhe të gjitha këto sfida i kemi tejkaluar me sukses, sepse jemi dëshmitarë të gjithë se kemi pasur disa vlerësime në Këshillin e Sigurimit për ecurinë e proceseve në Kosovë. Pra, të gjitha këto kanë rezultuar me vlerësime pozitive, pozitive domethënë për Kosovës, për Kosovën dhe ne mendojmë që ky është një kontribut i jashtëzakonshëm i gjithëve dhe kjo punë në radhë të parë jo vetëm procesi, jo vetëm bisedimet, por në radhë të parë kjo neve na ka pru deri te kjo situatë që të përmbillet procesi. Përmbyllja e procesit të bisedimeve do të thotë që Kosova është gati për shtetësi dhe mendoj se meritohet për këtë jemi gjithë dhe duhet këtë ta pranojmë.

Është e vërtetë, siç edhe tha presidenti, ne gjatë bisedimeve kemi bërë edhe kompromise. Kemi bërë kompromise dhe këto kompromise mendoj se janë të arsyeshme, por kanë qenë të iniciuara nga gatishmëria jonë, kanë buruar nga natyra jonë si popull fitimtar, si popull zemërgjerë. Por gjithmonë ne e kemi pasur një qëllim të qartë. Qëllimi ka qenë krijimi i një shteti koherent, funksional dhe në kufijtë ekzistues. Çdo gjë me çka jemi pajtuar, çdo gjë çka kemi afruar nuk e ka rrezikua dhe nuk e rrezikon këtë qëllim të përbashkët. Dhe këto propozime tona u pranuan nga presidenti Ahtisari. Ai ka mirëpritur qasjen tonë aktive, konstruktive, zemërgjerësinë tonë dhe ka pranuar se nuk mund të ketë më kërkesa ndaj nesh, nuk mund të ketë më kërkesa për negociata të vazhdueshme, nuk ka hapësirë më për kompromise të reja dhe e ka përmbyllur procesin me propozimin siç thash.

Dinamika e paraparë, jemi dëshmitar të gjithë, ajo çka na është thanë edhe unë këtu po e them, e mendoj se është ashtu. Sot në duart e veta Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do ta ketë propozimin gjithëpërfshirës të Ahtisarit, do ta ketë propozimin që ne e kemi pasur këtu, do me thanë propozimin gjithëpërfshirë dhe do ta ketë rekomandimin e tij për definimin e statusit politik të Kosovës. Këtë ne ende se kemi parë, por kjo na është thënë prej t'i drejtpërdrejt që ai pa asnjë hezitim do të propozojë pavarësi

për Kosovën. Formula e propozimit të tij do të jetë pavarësi për Kosovën, fillimisht e mbikëqyrur nga faktori ndërkombëtar.

Këtë propozim gjithëpërfshirës, këtë rekomandim Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara më 26 të këtij muaji do t'ua shpërndajë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit në dijeni. Dhe, diku në fillim të prillit, Këshilli i Sigurimit do ta ftojë z. Ahtisari në një seancë ,ku ai do ta ketë rastin ta sqarojë këtë propozim, ta argumentojë këtë propozim dhe të kërkojë mbështetjen për këtë propozim. Pritet që nga kjo seancë fjala pavarësi do ta merr statusin e fjalës publike, do ta merr statusin e fjalës publike. Me të marrë statusin e fjalës publike pritet një mbështetje e fuqishme e aleatëve tanë, miqve tanë, mbështetësve të pavarësisë për këtë propozim, domethënë para Rezolutës. Dhe mandej pas këtij propozimi fillojnë negociatat për Rezolutën e re që do të jetë shumë e thjeshtë, nuk do të jetë e ngarkume, nuk do të jetë e komplikume dhe do t'i mbajë në vete tri gjëra.

E para ashtu siç tha presidenti do ta zhvlerësojë Rezolutën 1244 dhe me këtë akt pushon çdo lidhje politike me Serbinë dhe përfundon ,gjithashtu ,edhe mandati i UNMIK-ut.

E dyta, kjo rezolutë e re pritët që ta mbështetë, ashtu si është, planin e Ahtisarit, propozimin e Ahtisarit dhe

E treta, e mandaton prezencën e re ndërkombëtare dhe civile në Kosovë. Presim me plotë të drejtë që kjo rezolutë do të nxjerrët para përfundimit të muajit maj ose para Samitit të Vendeve më të Zhvilluara në Botë e quajtur G – 8, i cili do të mbahet më 4 qershor. Kështu që tendenca e miqve tanë, e partnerëve tanë është që në këtë samit të mos shkohet me çështjen e pazgjidhur të Kosovës.

Kjo është dinamika për të cilën ne jemi në dijeni dhe për të cilën deshëm që edhe ju të jeni në dijeni, t'i kemi informacionet e njëjta si ne, si edhe ju deputetë të nderuar si dhe opinionit. Unë kisha dashur që vëmendjen tuaj ta ndal në dy çështje:

E para, që ta dimë ta pranojmë se kemi ende shumë punë për të bërë duhet ta ruajmë përqendrimin, përkushtimin tonë për procesin. Kjo është e para.

Pa dyshim se Qeveria e Kosovës, po flas në emër të Qeverisë, ne do ta vazhdojmë në krijimin e kushteve të nevojshme në përgatitjen e Kosovës për të marrë mbi vete administrimin e Kosovës për të marrë mbi vete kompetencat që sot nuk i ka. Jemi të angazhuar së bashku edhe me partitë opozitare në grupet punuese për transicion dhe transicioni është duke shkuar mirë. Priten vendime të mëdha, vendime të mëdha për Kushtetutën, vendime të mëdha për simbolet tona shtetërore, ligje të ndryshme që derivojnë nga marrëveshja për statusin e Kosovës. Të gjitha këto janë nisma tanimë në rrugë të mbarë dhe besoj që ne bashkërisht do t'ia dalim dhe do të jemi të gatshëm në ditën e Rezolutës së re që të fillojmë implementimin e tyre në fazën kalimtare, që është paraparë 120 ditë pas Rezolutës. Neve na pret edhe ndërtimi i institucioneve të reja, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i Ministrisë së Mbrojtjes, i forcës së sigurisë, Shërbimit Inteligent të Kosovës, Këshillit Nacional të Sigurisë e shumë e shumë të tjera,

përfaqësive jashtë vendit të gjitha këto janë për ne. Veç ka përfunduar drafti komplet i Ministrisë së Punëve të Jashtme, ka filluar puna në draftin e Ministrisë së Mbrojtjes. Ky draft do të debatohet në radhë të parë në grupet e transicionit ku janë përfshirë edhe përfaqësuesit opozitës dhe duhet që të vazhdojmë në implementimin e këtyre. Por gjatë gjithë kësaj kohe duhet të vazhdojmë të përkujtojmë bashkësinë ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara se pavarësia e Kosovës është një zhvillim pozitiv, është një domosdoshmëri dhe është zhvillim pozitiv dhe është e vetmja gjë që duhet mbështetur dhe duhet zgjidhur sa më shpejt.

Kështu që ne jemi të vetëdijshëm se edhe në Këshillin e Sigurimit, por edhe në bashkësinë ndërkombëtare, por edhe në rajon, fqinji i parë verior është kundërshtar i pavarësisë së Kosovës. Dhe duhet pritur që do të kemi përpjekje për destabilizim të situatës në Kosovë, me qëllim të çojë deri te vonesat në proces, deri te stagnimi i procesit, deri te rishqyrtimi i procesit etj. etj. Duhet të jemi të vetëdijshëm që të bëjmë çmos të gjithë ne me kapacitetet tona, qoftë si institucion, qoftë si qytetarë që ta ruajmë qetësinë, stabilitetin, unitetin edhe politik edhe qytetar dhe ta bindim faktorin ndërkombëtar se vërtet në Kosovë është në vepër një demokraci e pjekur, është një vend tanimë i gatshëm i pjekur dhe duhet sa më shpejtë të merret vendimi për pavarësinë e Kosovës dhe kjo konsiderohet si një hap pozitiv, jo vetëm për Kosovën, por edhe për rajonin.

Dhe momenti i dytë që desha të cekim është, duhet të pranojmë se kemi arritur shumë, kjo është një arritje që është arrit, është një shpërblim i sakrificave të brezave të tërë i luftës tonë, përpjekjeve tona për liri dhe pavarësi dhe është një i arritur e gjithë neve që sot historia deshi të na dhurojë këtë fat që të jemi aktorë të kësaj ngjarje madhore. Sepse, ne sot jemi në vëmendje të Kombeve të Bashkuara, të të gjithë komuniteti ndërkombëtar që merret me Kosovën. I gjithë komuniteti ndërkombëtar, tani shumica kanë kuptuar se e drejta është në anën tonë dhe kemi arritur të dëshmojmë me punën tonë me sakrificën, përpjekjet tona që kjo çka ne e kërkojmë e kemi merituar shumë më herët dhe të gjitha këto janë vonesa historike që kanë ndodhë deri tani.

Duke pasur këtë propozim në tavolinë pa alternativë nuk do të ketë bisedime për propozimin që modifikohet apo jo, të ndryshohet apo jo, të mbështetet apo jo, ky është diskutimi, kjo është çështja. Por ne jemi tani në pozitë të veçantë, në pozitë shumë të veçantë dhe shumë të mirë. Deri më sot ne kemi qenë ata të cilët kemi evokuar për pavarësinë e Kosovës, kemi argumentua pavarësinë e Kosovës, kemi kërkuar që të mbështetet pavarësia e Kosovës. Që nga 10 prilli ky projekt, ky propozim nuk është vetëm yni, është edhe i z. Ahtisarit, është i anëtarëve të Grupit të Kontaktit, thjesht pesë prej tyre më në fund, domethënë, ky është edhe propozim i tyre për pavarësinë e Kosovës. Nuk llobojnë më vetëm institucionet tona, por llobojnë edhe ai, është prodhim i përbashkët i Ahtisarit i Kombeve të Bashkuara i Grupit të Kontaktit dhe është prodhim edhe i Kombeve të Bashkuara. Kështu që, tanimë, të gjithë jemi në mbështetje të këtij propozimi, në radhë të parë askush nuk ia dëshiron dështimin, dështim i kalimit apo i sigurimit të mbështetje për këtë propozim nuk do të jetë vetëm i yni, i Grupit Negociator, që sot është shumë kush është i gatshëm që çdo dështim të na vesh neve, do të jetë dështim edhe i tërë procesit dhe do të jetë dështim i Kombeve të Bashkuara i Grupit të Kontaktit i partnerëve tanë ndërkombëtarë. Kështu që kjo na bënë të besojmë që nuk do

të lejohet dështimi, nuk do të lejohet që ky investim i madh që është bërë në ndërtimin e Kosovës deri këtu, por edhe ky investim i madh që është bërë edhe në këtë proces, kështu që po them prapë, të jemi, të ndihemi pjesë e këtij procesi të gjithë dhe ta vazhdojmë punën, kemi shumë punë të bërë. Unë jam i gatshëm për bashkëpunim, unë dhe qeveria dhe presim një bashkëpunim edhe nga ju. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. kryeministër. Fjalën e merr Hashim Thaçi, anëtar i Ekipit Negociator dhe kryetar i Partisë Demokratike.

ANËTAR I GRUPIT TË UNITETIT HASHIM THAÇI – I nderuari president, i nderuari kryesues, deputetë të nderuar, mysafirë të pranishëm.

Qytetarë të nderuar!

Fillimisht dëshiroj t'i falënderoj qytetarët e Kosovës për mirëkuptimin dhe besimin e treguar ndaj Ekipit të Unitetit, në përkushtimet e tyre për të përmbyllur, angazhimet tona për statusin politik në takimin që ka ndodhur në Vjenë. Pastaj më lejoni të nderuar deputetë, të shpreh respektin ndaj punës së të gjithë anëtarëve të Ekipit të Unitetit, të Ekipit Politik dhe Strategjik dhe gjithë njerëzve të involvuar në angazhimet, e përmbylljes së punës për statusin politik të Kosovës dhe dy përbërjet, të Ekipit të Unitetit, përbërjen e parë me president zotin Rugova, zotërinjtë Daci, Kosumi, Surroi, gjithashtu edhe përbërja në angazhimet shtesë dhe të vazhdueshme, të presidentit Sejdiu, zoti Berisha, Çeku, Surroi.

Dua të shpreh respekt, për mirëkuptimin besimin dhe mbështetjen e gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës për ekipin e unitetit, por dhe falënderim, për punën dhe mbështetjen e gjithë ndërkombëtarëve, të Grupit të Kontaktit në angazhimet tona të përbashkëta, që të zgjidhet statusi politik sa më shpejtë që është e mundur.

Të nderuar deputetë! Sot për qytetarët e Kosovës, ka vetëm një lajm, ky lajm është i mirë jo befasues, i vonuar por shumë meritë. Dita e sotme 14- marsit është datë e rëndësishme për Kosovën, sepse së shpejti në Këshillin e sSgurimit dorëzohet dokumenti i presidentit Ahtisari. Nuk do të ketë më tutje dhunë, vrasje e përndjekje, për popullin e Kosovës. Nuk do të ketë edhe më tutje paqartësi për statusin politik të vendit. Nga sot e hetojmë kohën e vendimeve për zyrtarizmin e pavarësisë. Kosova është vend me histori të dinitetshme, por edhe me një vizion për të ardhmen perëndimore. Kosova ndodhet në momentin më vendimtar dhe historik të saj, që nga përfundimi i luftës. Fitorja në qershorin e vitit 1999 dhe krijimi i realitetit të pavarësisë së Kosovës, tani shtatë vite më vonë, po numëron ditët e fundit të konfirmimit, të pranimit ndërkombëtar, përmes njohjes së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

Periudha e këtyre viteve ka treguar edhe më fuqishëm, se kjo është e vetmja zgjidhje, që garanton sukses në projektin e madh të lirisë, demokratizimit dhe integritetit evropian, të Kosovës dhe rajonit si dhe perspektivë të sigurt ekonomike për qytetarët e vendit. Pas një vitit të takimeve të rregullta në Vjenë, të shtunën e kaluar, përfunduan edhe këto takime me ndërmjetësimin ndërkombëtar në mes të Kosovës dhe Serbisë. Prishtina ka mirëpritur dhe pranuar dokumentin e presidentit Ahtisari, Perëndimi ka përshëndetur

qëndrimin tonë, ndërsa Beogradi ka refuzuar procesin. Pas pak orësh në Nju-Jork, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së do t'i dorëzohet dokumenti i presidentit Ahtisari, Sekretarit të Përgjithshëm.

Në dokument me besim të pa luhatur, pa asnjë dilemë, Kosova do të emërtohet shtet i pavarur.

Të nderuar deputetë! – i nderuari president, kryeministër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të qarta për të ardhmen e Kosovës, prandaj populli i Kosovës dhe politika kosovare, u janë shumë mirënjohës. Bashkimi Evropian edhe pse me dallime në nuanca apo qasje, ka unifikuar dhe qartësuar qëndrimin. Pra, jam i sigurt se, edhe Brukseli do të përkrahë fuqishëm dokumentin, për të ardhmen e Kosovës. E ardhmja jonë është e ardhmja e përbashkët e vlerave evropiane perëndimore, dua ta shpreh besimin bashkë me qytetarët e vendit, se edhe Rusia, do të jetë partnere e jo pengesë, në procesin e nxjerrjes së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit për Kosovën.

Tash e 8 vite, Moska zyrtare ka qenë mbështetëse, apo edhe partnere e botës demokratike për Kosovën, besoj që historia do ta kujtojë Rusinë, si vend që ka marrë qëndrim të drejtë për Kosovën, për paqen dhe stabilitetin rajonal. Pas nxjerrjes së Rezolutës së re të Këshillit të Sigurimit, të nderuar deputetë, Parlamenti i Kosovës do ta proklamojë fuqishëm vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Kosova do të ketë Kushtetutën e vetë moderne.

Të nderuar deputetë! Përcaktimi i Prishtinës, për reformimin e pushtetit lokal, modern, nuk u mbështet në baza etnike, ose në motivime politike, apo pretendime territoriale. Por me qëllim më të mirë, që pushteti të jetë sa më pranë qytetarit dhe në shërbim të tij. Në Kosovën e re do të kemi edhe komuna të reja, besojmë funksionale. Prishtina u zotua dhe mori përgjegjësi shtesë për respektimin dhe kultivimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve në Kosovë. Një e drejtë e respektuar, për një qytetar apo etni, do të jetë e respektuar dhe e garantuar për të gjithë. Dokumenti ndërkombëtar për Kosovën, është baza dhe jo limiti për të ardhmen. Është fillim i ri për të ardhmen e re të Kosovës.

Kosova, u tregua zemërgjerë në raport me komunitetet pakicë, u respektua parimi afirmativ i përfaqësimit, në institucionet dhe kultivimit i të drejtave të tyre, në të gjitha sferat e jetës brenda shoqërisë kosovare.

Të nderuar deputetë! Kosova do të jetë shtet i qytetarëve të Kosovës, Kosova po ndërton dhe do të kultivojë identitetin shtetëror dhe demokracinë qytetare. Do të kemi simbolet tona shtetërore, që do të përfaqëson identitetin dhe unitetin qytetar dhe territorial të vendit. Kosova do të jetë republikë parlamentare, do të ndërtojë institucione shtetërore, funksionale dhe efektive, do të bëjmë në mënyrë të përgjegjshme ballans të pushteteve, duke zhvilluar edhe ekonomi të lirë të tregut. Kosova do të ndërtojë fqinjësi të mirë me vendet përreth, do të hapë mundësi të sigurt për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Kosova ka ftuar dhe mikpritur prezencën civile dhe ushtarake ndërkombëtare. Kosova me zotim të lartë merr përgjegjësinë për implementimin e marrëveshjes, për të ardhmen e Kosovës në bazë të dokumentit të presidentit Ahtisari.

Kosova zotohet për zbatimin e reformave demokratike në Kosovën e re pas-statusore. Prandaj, të nderuar deputetë, edhe një herë i ftoj të gjithë për unitet politik dhe qytetar, në mënyrë që bashkërisht dhe në bashkëveprim, ta realizojmë ëndrrën tonë për liri, shtet të pavarur dhe sovran. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit zoti Thaçi, një bashkëbisedim me shefat e grupeve parlamentare për këtë seancë. Kemi preferuar që, fjalën ta marrin shefat e grupeve parlamentare dhe unë e ftoj Alush Gashin, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari zoti kryesues, i nderuari zoti president, zoti kryeministër, Delegacioni i Unitetit, ministra dhe të çmuar deputetë!

E mirëpresim njoftimin për përfundimin e bisedimeve në Vjenë më 10 mars, që nga vendimi i presidentit Rugova që të formohet Delegacioni për bisedime eventuale me bashkësinë ndërkombëtare, ne je kemi mbështetur në kontinuitet si në vitin 2005. Ju kemi ftuar në interpelancë dhe informatë në vitin 2006, kemi biseduar në një debat të gjerë kohë më parë dhe në veçanti sot e mirëpresim gatishmërinë që ju keni kërkuar që të na njoftoni për bisedime. Gjatë këtij procesi të bisedimeve si deputet në një mënyrë të lakmueshme kemi demonstruar një unitet në këtë seancë dhe angazhohemi që tani kur puna e zellshme e delegacionit të unitetit bartet në Kuvendin e Kosovës, për implementimin e marrëveshjes përmes të ligjeve, që uniteti i demonstruar në delegacion të unitetit, të vazhdojë të demonstrohet në Kuvendin e Kosovës dhe në të gjitha institucionet e Kosovës, për të mirë të jetësimit të pavarësisë së plotë të vendit tonë.

Ne jemi të vetëdijshëm, se fuqia e demokracisë së vendit tonë, do të varet dhe do të çmohet nga aftësia jonë e përbushjes së drejtave të pakicave. Ne do të angazhohemi që, në këtë proces të jemi shembull i mirë. Jemi të vetëdijshëm se, në negociata kompromiset janë të domosdoshme dhe zoti president, ne e kuptojmë që janë bërë kompromise të dhimbshme, ashtu siç keni konstatuar edhe në përmbyllje të bisedimeve. Ne jemi të vetëdijshëm që, është koha e angazhimeve të jashtëzakonshme, në jetësimin e kësaj marrëveshjeje që kërkon dije, përkushtim dhe në veçanti kërkon një qasje të sinqertë, përbrenda institucioneve të Kosovës. Ne duhet të angazhohim shumë për ndërrimin e përceptcionit, që kanë minoritetet për ne, si dhe duhet ta fitojmë respektin e bashkësisë ndërkombëtare si ni shtet i ri, që del në arenë ndërkombëtare.

Ju do ta keni mbështetjen tonë dhe energjia jonë nuk do të mungojë në realizimin e një Kosove të pavarur dhe sovranë, gatishmëria për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit, apo vendimi që do ta maarrë ky Kuvend, a në një aranzhim tjetër eventual, nga grupi ynë do të jetë i plotë, zoti president. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI - Ju faleminderit zoti Gashi, në emër të Partisë Demokratike, flet Jakup Krasniqi kryetar i Grupit.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Zoti kryesues, zoti kryetar, kryeministër, zoti Thaçi, të nderuar deputetë dhe ju mysafirë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës edhe pse në opozitë nga fillimi ka mbështetur, ka ndihmuar gjithë procesin politik, që është zhvilluar në Vjenë, gjatë këtyre këtyre dy viteve. Pra, falënderon kryetarin e Grupit Negociator dhe gjithë trupat, gjithë Grupin Negociator dhe trupat politike dhe profesionale të tij në kontributin që kanë dhënë gjatë këtij procesi në prezantimin e vullnetit të qytetarëve të Kosovës, për shtet të pavarur dhe sovran.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, ju falënderon si Grup i Unitetit, falënderon gjithë trupat tuaj që kanë kontribuar që gjithë procesi politik, të vijë në këtë shkallë që ka ardhë dhe jemi të bindur se procesi i Vjenës përfundoi dhe shpresojmë që brenda një kohe të shkurtër, do të përmbyllet i tërë procesi duke respektuar vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike respekton çdo vendim të ardhshëm që është në përputhje me vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe do të marrë të gjitha obligimet që do të dalin për institucionin e Parlamentit.

Jemi të bindur se, në Vjenë është bërë një kompromis i dhimbshëm, por është bërë një kompromis, jo për të kaluarën, është bërë një kompromis për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës, për të ardhmen tonë dhe në këtë proces kemi marrë pjesë, kemi dhënë kontributin tonë dhe për këtë proces dhe gjithë procesin në vazhdim do të ketë mbështetjen e Grupit Parlamentar të PDK-së. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Krasniqi, fjalë e merr kryetarja e Grupit Parlamentar të AAK-së

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - I nderuar z. kryesues, i nderuar z. president, z. kryeministër Z. Thaçi z. ministra,

Ne si grup parlamentar kemi debatuar në Kuvend hollësisht dhe e kemi mbështetur jo vetëm punën tuaj, por edhe prodhimin e atij procesi dokumentin e Ahtisarit duke dhënë vërejtjet tona lidhur me atë dokument.

Të nderuar deputetë,

Ditët që po vijnë për Kosovën dhe të ardhmen e popullit të saj janë shumë të rëndësishme. Tanimë procesi i bisedimeve i udhëhequr nga presidenti Ahtisari është përmbyllë, kurse presidenti Ahtisari do ta dorëzojë dokumentin në KS të OKB-së. Dokumenti është rezultat i zhvillimeve nëpër të cilat kemi kaluar dhe hap mundësinë që të merret vendim më i avancuar për ne. Gjatë këtij procesi populli i Kosovës ka treguar durimin dhe besimin e vet në përfundimin pozitiv të procesit.

Dokumenti i propozuar nga presidenti Ahtisari është një dokument që e ndërprente rendin e mëhershëm shoqëror, i lejon Kosovës një rend të ri që i hap perspektivën që Kosova të vendosë për veten, dhe në harmoni me aktorët vendimtar ndërkombëtar.

Në të njëjtën kohë akomodon serbët e Kosovës dhe i jep zgjidhje aranzhimeve të reja me bashkësinë ndërkombëtare.

Me dokumentin e Ahtisarit hapet mundësia që Kosova vetë ta deklarojë pavarësinë dhe të fitojë njohjen ndërkombëtare.

Presim që Rezoluta për vendosjen e këtij rendi të ri shoqëror të aprovohet në Këshillin e Sigurimit sa më shpejt, ashtu që ne të jemi të lirë me definuar veten shtet i pavarur dhe sovran.. Njëkohësisht të shfuqizohet Rezoluta 1244 po ashtu kemi besimin se vendimi për Kosovën do të jetë i drejtë, thënë shkurt se do ta njohin atë çka Kosova do të vendos për veten.

Tani më e dimë se si do të duket shteti ynë.

Ne do ta qeverisemi nga Kushtetuta jonë, ligjet tona, do t'i kemi simbolet e shtetit, mundësinë për të qenë anëtar të organizatave ndërkombëtare politike dhe financiare.

Por, do ta kemi mbikëqyrjen ndërkombëtare që do të mbikëqyrë aranzhimet e brendshme dhe jo vetëm pavarësinë.

Por, le të jemi të sqartë me veten tonë. Mbikëqyrja është në interesin tonë. Sot për sot, për të mbajtur territorin tonë na duhet NATO-ja. E prezenca e NATO-s rrjedhimisht kërkon prezencën civile që vlerëson, shqyrton dhe vepron në bazë të vlerësimeve të qendrave vendimmarrëse. Është fakt i vërtetuar se pa miq, pa mbështetje, pa i takuar një pjese të botës që beson dhe investon në një vend është vështirë me arritë me u bë anëtar i familjes së shteteve.

Për të realizuar të drejtën tonë dhe marrë vendimin për veten, duhet të kujdesemi që të ruajmë bashkëpunimin, mbështetjen dhe besimin e miqve tanë që kanë qëndruar edhe më parë me ne, në veçanti të SHBA-së, NATO-s dhe BE-së. Kjo kërkon angazhimin tonë për të forcuar argumentet se Kosova është vend që merr përgjegjësinë dhe punon për shoqëri moderne demokratike, me të drejta të avancuar për minoritetet dhe kontribuuese e stabilitetit në rajon dhe më gjerë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Qëllimi i vlefshëm i popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi, sovranitet dhe perspektivë e ka çmimin e vet sfidues. Me lirinë vijnë obligimet. Me shtetin vijnë përgjegjësitë. Me aspiratën për pronësinë, vijnë zemërgjerësia individuale dhe kolektive që korrespondon me mirëqenien e përgjithshme.

Prandaj, sfida para nesh është marrja e përgjegjësive të reja dhe zbatimi i pakos së Ahtisarit. Ne jemi gati t'i marrim përgjegjësitë dhe t'i implementojmë ato.

Tanimë e dimë sakt se duhet ti fokusojmë energjitë tona për zhvillimin stabil të Kosovës, që qytetarët e Kosovës të kenë një jetë normale, ekonomi normale, raporte normale mes veti dhe me pjesët e tjera të botës. Më tej, vazhdon rruga jonë për krijimin e partneritet të ngushtë me BE-n dhe anëtarësimin në NATO-n dhe BE-në.

Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit! Fjalën e ka z. Teuta Sahaqija në emër të Partisë ORA

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryesues. z. president, z. kryeministër, z. Thaçi, të nderuar kolegë deputetë ministra.

Procesi i negociatave përfundoi. Fillimin e këtij procesi e kemi mirëpritur sepse çdo fillim e ka përfundimin dhe përfundimi e ka produktin, produkti është pavarësia e Kosovës. Gjatë kësaj kohe vëmendja e të gjithë segmenteve të shoqërisë kosovare ka qenë e koncentruar pikërisht në procesin e negociatave. Por nuk kemi qenë ne të vetmit, kjo vëmendje ka qenë gjithashtu, edhe e bashkësisë ndërkombëtare, ky proces i cili ka filluar së bashku me miqtë tanë, ky proces edhe do të përfundon me miqtë tanë.

Formimi i Grupit të Unitetit ka qenë një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse ka treguar unitetin, unitetin pa marrë parasysh a janë në pozitë apo në opozitë, e ka treguar seriozitetin dhe angazhimin e institucioneve për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Sidomos vlen të theksohet se roli i opozitës ka qenë një rol jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe jashtëzakonisht i vështirë duke pas parasysh rolin tonë si opozitë.

Dokumenti i z. Ahtisari është një dokument që është rezultat i punës dhe i procesit, gjithashtu, është edhe rezultat i kompromiseve për të cilët të gjithë më parë folën. Por, pas dokumenteve të Ahtisarit na presin sfidat. Këto sfida janë: sfidat afatshkurtra sikur Rezoluta e Këshillit të Sigurimit, dhe proceset e tjera tona të brendshme që varen prej bashkësisë ndërkombëtare. Po gjithashtu janë edhe proceset edhe sfidat afatgjata sikur që është implementimi i marrëveshjes, janë sfidat ekonomike që do të dalin në sipërfaqe menjëherë ditën e ardhshme pas pavarësisë. Do të jetë sfida afatgjate ndërtimi i institucioneve demokratike dhe duhet ta keni parasysh se një ditë pas shpalljes së pavarësisë pasi që Kosova të jetë shtet i pavarur, po atë ditë durimi i qytetarëve që ka qenë i maskuar dhe në pritje të zgjidhjes së statusit nuk do të ekziston më, prandaj duhet të kemi jashtëzakonisht shumë kujdes dhe ta kemi parasysh këtë sfida shumë të vështirë, sepse nuk do të jenë qytetarët më të gatshëm të sakrifikohen për statusit.

Sfidë tjetër është që Kosova duhet të dëshmohet si e denjë për të qenë shtet dhe për të vazhduar të jetë shtet.

Me këtë duhet të dëshmojnë institucionet tona, duhet të dëshmojnë që sundimi i ligjit, që lufta kundër dukurive negative është prioritet i institucioneve të shtetit të Kosovës. Duhet të dëshmojnë institucionet tona që janë institucione demokratike, në mënyrë që rruga për integrimin e shtetit të Kosovës në Evropë dhe në NATO të jetë rrugë e trasuar dhe rrugë e cila në afatin më të shkurtër do të na qon deri në Bashkësinë Evropiane dhe në NATONë. Ne sot jemi duke jetuar në një kohë historike, në një kohë jashtëzakonisht të rëndësishme, dhe përgjegjësitë tona përgjegjësitë e institucioneve dhe përgjegjësitë e të gjithë individëve duhet të jenë konform kësaj përgjegjësie dhe kohe në të cilën jetojmë.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit! Z. Sahatqija. Në emër të Grupit 6+, Xhezair Murati.

DEPUTETI XHEZAI R MURATI – Hvala vam g. Predsedavajući. Poštovani predsedniče, poštovani premijeru poštovani g. Thaqi, gospodo ministri, kolege.

Današnja vanredna sednica posvećena okončanja pregovaračkog procesa je zaista historijski dan i mislim da smo ovim okončali decenijske vjekovne težnje građana Kosova. I ovo je danas prilika da svi građani treba da budu dobro informisani oko čitavog ovog procesa stoga u ime parlamentarne grupe zahvaljujem sazivanje današnje vanredne sednice i nadam se da će ona dati svoj doprinos kako su to do sada i moj kolege iznjeli.

Nakon zadnjih sastanaka i finalnog predloga predsednika Ahtisarija, smatram da je ovaj predlog dobra osnova za određivanje statusa Kosova i kao mogućnosti boljeg života za sve građane Kosova.

Nažalost i zadnji predlog je prevashodno orijentisano maloviše ka jednoj zajednici, i njihovim pravima i garancijama. No i pored toga nadam se da će konačno rešenje ipak odgovoriti zahtevima i većinske i ostalih svih zajednica kako se svi tome nadamo. Svakako da postoji šansa da se kroz Ustavne i drugih Zakonskih odredaba zadovolje potrebe dakle pomenutih zajednica. Te da će konačnim rešenje statusa Kosova stvorit ćemo jedno društvo funkcionalna, demokratska, multietnička i stoga želim da naglasim da smo veoma zadovoljni da nakon puno truda i političkih angažovanja u osnovnim odredbama finalne verzije i pored zvaničnih jezika, stoji da će i bosanski i turski jezik zbiti zvaničan ili u zvaničnoj upotrebi u sredinama ili mestima gde žive i bošnjaci i tursci u većem broju. Zadovoljni smo što je Centralna izborna Komisija proširena za članove ostalih zajednica, naravno da smo očekivali i neke druge izmene koje smo zahtjevali ali vam je poznato da ostale zajednice nisu imali svoje predstavnike niti u Glavnoj niti u strateško-političkoj grupi za pregovore, nezavisno od toga smatram da smo bili na visini zadatka i bili aktivni, kroz konstativni savet zajednica dali svoj doprinos procesu pregovaranja oko budućnosti Kosova. I pored toga što mnoge odluke konsultativnog saveta nisu na adekvatan način uzete u obzir od strane Pregovaračke ekipe i UNOSEK-a, mi smo nastavljali sa svojim aktivnim radom i dali maksimalno i svoj doprinos primedbe pa smatrali da treba da budemo podstrekači procesa rešavanja statusa u korist građana Kosova ono jel da što se nalazi pred nama.

Zadnji primeri našeg aktivnog rada su zaključci Konsultativnog Saveta iz Antalije, odakle su prihvaćene formulacije oko jezika, ali prava obrazovanja, stečenih prava, imenovanja zajednica i i tako dalje i ako nisu pomenuti smatramo da ćemo kroz ovaj izradu ustava i kroz uzradu zakona o pravim manjinskih zajednica biti uključena na nivou kako je to potrebe građana izuskuju i kako je to i međunarodni zakoni i konvencije rešavaju. Mi smo spremni da i dalje radimo konstruktivno i aktivno u budućem procesu i prelaznom periodu. Stoga u ovom periodu takodjer očekujemo i više sluha od predstavnika većinske zajednice za naše zahteve, a naročito od koalicionih partnera. Neophodno je svakako u više budućnosti u više razumevanja i konkretne podrške kada je u pitanju naš jezika, obrazovanja i izbornih Zakona i tkd. Ja mogu danas ovde gospodo da pomenem da je veliki dio posla iza nas. Ali je sigurno da ništa manji posao nije pred nama. Očekuje nas mplementacija svega što je dogovoreno zakonodavna rešenja ali realizacija svega u svakodnevni život, prema tome još jednom navodim da parlamentarna grupa 6+ prihvata sve što je postignuto i ostaje odlučan saveznik do okončanja svega što

je pred nama. Ovaj period treba da se iskoristi za dalja jačavanje veza izmedju većinske i ostalih zajednice i kako to svi ovdje navodeno kako je to traženo i kako je na graju do sada i rađeno. U ovom periodu treba više strpljenja, više profesionalnosti, više konsultovanja, a i svakako sačuvati jedinstva sačuvati rečavanja statusa izmedju predstavnika većinske zajednice, ali i predstavnicima manjinskih zajednica u čemo možemo sa ponosom da kažemo da smo mi u ovom historijskom procesu dali dovoljna udio. Budućnost Kosova svakako još jednom naglašavam pripada svima nama, bez obzira na brojnost ili etničku pripadnost, ovo je prilika da zahvalimo i pregovaračku ekipi i međunarodnoj zajednici na svemu što je urađeno i jel da poziv na ovaj da preostalom periodu okončamo što pred nama očekuju i stanovnici i birači na kraju buduće generacije Kosova. Evo zahvaljujem još jednom.

KRYESUESI SABRI HAMITI :- Ju faleminderit z. Murati. Fjalën e ka Gjergj Dedaj në emër të Grupit për integrim.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Nuk dua me ju kritiku sot. Ju faleminderit shumë Z. Kryesues, i nderuar president Sejdiu, kryeministër Çeku, z. Thaçi, të nderuar ministra, kolegë deputetë, mysafirë

Flas në emër të Grupit parlamentar për Integrim, grup siç e dini që përfaqëson 6 subjekte politike dhe 5 komunitete. Është një grup që njëkohësisht përmes përfaqësuesve të komuniteteve në Këshillin konsultativ të komuniteteve ka dhënë kontribut për këtë pako të Ahtisarit, por si grup edhe si përfaqësues deri me 2 shkurt kemi qenë mjaft të shqetësuar dhe kritik lidhur me rrjedhën e këtyre bisedimeve posaçërisht një kohë të gjatë ka munguar një transparencë ndoshta me arsye e Ekipit Negociator dhe shqetësimet tona duhet t'i kuptoni si mjaft të arsyeshme, sepse për këtë ditë e për ditët që po na presin ky popull e të gjithë ne kemi sakrifikuar mjaft, prandaj pavarësia e Kosovës e cila hapë rrugë drejtë perspektivës evropiane dhe të integritit të Kosovës në NATO në Bashkimin Evropian është pa alternativë dhe shpresojmë që Ekipi Negociator por edhe president Ahtisari e kanë pasur parasysh, por është një sugjerim me qëllim të mirë i yni, siç thotë populli është mirë që mos të bëhet hop pa u krye gardhi sepse është ky një draft projekt dhe kjo ditë që sot dorëzohet është e rëndësishme pa dyshim, por e rëndësishme dhe historike është atë ditë kur ky projekt aprovohet në Këshillin e Sigurimit, kur kihet parasysh se ka tendenca ndoshta që të ketë edhe veto sepse me ju thënë se liderët e institucioneve të Kosovës duhet tash, në këtë fazë t'i ulin poshtë flamujt partiak, interesat personale dhe të jenë unik se po bëhet fjalë për një moment më shumë se historik, për një moment të shenjtë dhe tepër të veçantë për të respektuar vullnetin e këtij populli të martirizuar për vetëvendosje dhe pavarësi.

Është mirë që liderët e institucioneve dhe të forcave politike dhe grupet parlamentar e që të fillojnë një ofensive në qendrat ndërkombëtare të vendosjes për të kërkuar që ky projekt të aprovohet në Këshillin e Sigurimit dhe që mos të shtyhet me çështja e statutit të Kosovës sepse u bë 8 vite pritje, shqetësime, tensione, prolongime të cilat mund të prodhojnë një krizë me pasoja të parashikueshme. Edhe një herë Ekipit të Unitetit i dëshiroj sukses. Shpresoj që nga ky takim tash e tutje do të dalim edhe shumë më unik sepse kanë një mision tepër të veçantë e tepër të shenjtë që ta bëjnë realitet pavarësinë e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Dedaj. Tash i kemi edhe tre deputetë që janë paraqitur. Unë të treve do t'ua jap fjalën Emrush Xhemajli, kryetari i Lëvizjes Popullore

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – I nderuari president i Kosovës, i nderuari kryeministër, i nderuari kryesues, i nderuari z. Thaçi, të nderuar kolegë deputetë, ministra dhe gjithë ju që jeni prezentë, ju përshëndes

Për ditën e sotme unë i përshëndes njoftimet që u dhanë këtu dhe e konsideroj me vend faktin që dha ky njoftim, ndërsa sa i përket pakos të Ahtisarit, të gjithë i kemi shprehur mendimet dhe unë nuk do ta përsërisja qëndrimin e Lëvizjes Popullore të Kosovës lidhur me këtë, vetëm do të thosha atë që dihet se pakoja e Ahtisarit është e ndryshme nga Rezoluta 1244, mund të quhet një hap përpara, por është shumë larg asaj që i ka takuar dhe që i takon popullit tonë, sepse populli ynë me kohë e ka merituar dhe e meriton edhe i takon pavarësia e plotë me monitorim të përhershëm, por na të gjithë e dimë se perioda e ardhshme është përsëri një status i ardhshëm i Kosovës dhe i jo definitiv, sepse bëhet fjalë për një prani të rëndë ndërkombëtare të cilin na e dimë të gjithë se çfarë do të jetë. Ky është qëndrimi i shkurtër dhe nuk do të doja ta përsëris. Unë e përshëndes vëmendjen që tërheq ajo që tha z. kryeministër se na pret një periudhë e vështirë e ardhshme, një periudhë ku priten vështirësi për Kosovën edhe në fushën e sigurisë, duke pasur dronë shumë të arsyeshme që Serbia me gjithë mekanizmat e vet që i ka këtu prezent në Kosovë, e që i dimë ne të gjithë dhe ato jashtë Kosovës, do të bëjë përpjekje për destabilizimin e vendit. Por, këtu ju kisha lutur institucioneve që të mos i shtimë thera në komë të shëndoshë vetvetes, t'i teprojmë gjërat edhe sot me 14 mars kur po dorëzohet pakoja e Ahtisarit në Kosovë ende të ketë të burgosur, që na e dimë se janë politikë, është fjala për z. Albin Kurti: mund të kualifikohen kundërvajtje veprimet që i kundërshtojnë, d.m.th. ajo që dihet se ka ndodhur. Kjo çka ka ndodhur nuk është vepër penale, zonja dhe zotërinj në kuptimin kriminel, kjo është thjeshtë një arsye politike pse ai mbahet aty. Këtu u shpjegua roli i Grupit të Unitetit në bisedime, por nuk shpjegua roli i Grupit të Unitetit në ditën e 14 marsit edhe për mbajtjen e Albin Kurtit në burg. Ju lutem kjo nuk mund të jetë çështje e vogël dhe qysh mbahet për arsye politike dhe qysh keni ndikuar ju si Grup i Unitetit që ai të jetë aty. Ju mundeni me ndikua edhe ju ftoj publikisht që të kërkoni lirimin e tij edhe të burgosurve të tjerë politikë nëse ende ka. Kjo është për të mirën e stabilitetit të vendit dhe mendoj se në këtë formë shkohet si popull unik drejt të ardhmes. Ndërkaq, i bashkohem fjalës së z. të parafolësit të mëhershëm z. Dedaj, që tha; Ky është propozim që e ka bërë z. Ahtisari. Ne duhet të presim në qetësi për vendimin e mëtutjeshëm dhe jo të përfshihemi nga euforia në formën se si u dëgjuan diskutimet e mëhershme. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Xhemajli. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryesues, profesor Hamiti, i nderuari president Sejdiu, i nderuari kryeministër Çeku, i nderuari anëtar i Ekipit prezent Thaçi.

Unë nuk dola të flas në emër timin si deputet, por dola të konfirmoj dhe t'ju njoftoj, se edhe kjo ka kaluar procedurën e paraparë me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe të flas emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Jam mirënjohës dhe mirëpres njoftimin mbi ecurinë e bisedimeve në Vjenë. Natyrisht, duke konfirmuar se Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk ka pasur mundësi dhe as nuk ishte kyçje në procesin e bisedimeve lidhur me këtë projekt. Megjithatë, unë mendoj se njoftimi i sotshëm, duke e çmuar si të vlefshëm ka qenë dashur të jetë më përmbajtjesor me të dhënat e sakta dhe ky njoftim i sotëm duhet të ketë qenë i lidhur me dokumentin e Ahtisarit në rend të ditës edhe pse nënkuptohet me plotësimet dhe ndryshmet e paraqitura nga Ekipi Negociator, me ato plotësime dhe ndryshime të aprovuara dhe të pa aprovuara dhe natyrisht se ne sot, gjegjësisht grupi ynë ka pritur që të njoftohemi edhe me çështjet e hapura, që kanë shtruar dilema dhe të cilat kanë mbetur s'çështje që kërkojnë zgjedhje të mëtutjeshme. Unë do t'i theksoj në pika të shkurtëra vetëm disa: Zonat e mbrojtjes të trashëgimisë kulturore të Veriut të Kosovës me theks të veçantë ato kombëtare dhe fetare që nuk janë përfshirë dhe një pjesë shumë e vogël që është përfshirë dhe krijojnë probleme. E dyta, Bordi i qytetit të Mitrovicës për të cilin do të lindin probleme funksionale dhe i cili në kuptimin formal-juridik nuk do të funksionalizohet. E treta, konstituivi i një universiteti etnik në Kosovën multietnike pozicioni i pranisë civile në Kosovë, çështja e zonave të hapësirës kufitare që është me rëndësi Maqedoni – Kosovë, decentralizimi që është imediat për Kosovën, por është vetëm mbi baza etnike dhe të gjitha këto duke marrë ose jo përgjigje, ne i kemi diskutuar paraprakisht, por sot mbetën të pashpjeguara. Ne mbesim me shpresë se dëshira, kërkesa dhe optimizmi i Grupit Negociator do të realizohet. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. deputet Kelmendi. Fjalën e ka kërkuar i fundit deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit z. kryesues, sigurisht që po ju bën përshtypje të gjithëve pse po e marr fjalën, por unë jam ithtar i kultivimit të mendimit ndryshe, ithtari i ballafaqimit të argumenteve dhe të mendimeve të ndryshme, prandaj edhe dola këtu që ta thyej atë unitetin që paskan arritur shefat për të mos e marrë fjalën asnjë deputet. Ky unitet nuk besoj se i duhet Kosovës as këtij Kuvendi. Unë mendoj se këtu është vendi ku duhet të debatohet, të shpalosen mendimet qofshin ato edhe të ndryshme, qofshin edhe të kundërta edhe kur nuk i pëlqejnë kryetarit, kryeministrit e tjera. Pak ka rëndësi kjo punë. Tjetër, unë mendoj që sot është dashur të kishte një debat më të gjallë, më të fuqishëm jo vetëm për çështjet e pakos ose të planit të Ahtisarit, sepse ai plan tashmë është miratuar dhe do të shkojë në Këshillin e Sigurimit, por edhe për gjendjen në Kosovë sot e tutje. Plani i Ahtisarit është pranuar nga Grupi ynë i Unitetit ose Grupi Negociator, por nuk ka kaluar në Këshillin e Sigurimit ka shumë pikëpyetje a do të kalojë apo nuk do të kalojë. Pastaj, edhe në qoftë se kalon prapë ka rreziqe të reja për Kosovën. Prandaj, ne nuk duhet ta bëjmë krejt rozë këtë situatë edhe siç dëgjuam këtu disa vjersha që u recituan, disa vetëlavdërime, sepse e ka thënë edhe kryetari, u tha edhe sot këtu se është bërë një kompromis i dhimbshëm për Kosovën dhe kjo është një e vërtetë që na dhemb gjithëve, edhe për këtë përgjegjësinë sigurisht do ta mbajnë ata që e kanë bërë kompromisin.

Është fakt se në Kosovë nuk mendojnë të gjithë si Grupi i Unitetit. Shoqëria civile, shoqatat e ndryshme, lëvizjet e ndryshme e kundërshtojnë këtë kompromis të dhimbshëm, nuk duhet me e harrue këtë fakt, prandaj unë mendoj që sot e tutje duhet të mendohet edhe për krijimin, ndërtimin, kërkimin e një konsensusi të ri në shoqërinë e Kosovës, nëse duam t'i përballojmë me sukses dhe pa dhimbje të reja zhvillimet që do të vijnë deri në kalimin e këtij plani në Këshillin e Sigurimit, po pas kalimit të këtij plani. Ndoshta duhet menduar për një tryezë politike të përhershme ku do të përfaqësohen edhe mendimet e tjera edhe shoqëria civile edhe lëvizjet e ndryshme, edhe shoqata të ndryshme edhe grupime të ndryshme politike ose qytetare, sepse kjo e ndihmon qëndrimin dhe qëndrueshmërinë e Kosovës në rrugën e saj të mëtejshme, sepse të gjithë jem të ndërgjegjshëm se në këtë plan z. kryetar nuk i është vënë pikë çështjes së Kosovës dhe nuk besoj se do t'i vihet.

Tjetër çështje, që edhe në bisedimet e fundit të Vjenës nuk është ndryshuar është çështja e kufirit, ka mbet çështja e kufirit me Maqedoninë, unë nuk mendoj se do të kaloj kaq lehtë kjo punë, prandaj është mirë Kuvendi ta ketë parasysh edhe institucionet edhe Qeveria.

Tjetër, me këtë Qeveri që e kem mbrapa nuk besoj se do të na shkojnë gjërat kështu siç po i bëjmë të gjitha rozë. Duhet të ndërtohen kapacitete pak më serioze, më të fuqishme, më përfaqësuese në fund të fundit, që të ruhet stabiliteti dhe të ecet më tej. Prandaj, mendoj që është mirë të kihet parasysh kjo gjendje që është në Kosovë, të mos vetë lavdërohem kaq shumë, ta shkojmë realitetin në sy ashtu siç është, sepse zhvillimet e reja nuk do të jenë aq të qeta dhe të pranueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI - Ju faleminderit z. deputet. Një shpjegim duhet të jepet megjithëse nuk do të kishte nevojë hiq. Diskutuesi i fundit e hupi nja një minutë e gjysmë tue luajt të flijuemin. Përkundrazi unë ia dhashë fjalë, d.m.th. është bajate të flitet kur fjala iu dha, ndërsa konsensusi kur mbërrihet në mes grupeve parlamentare ky duhet të respektohet, sepse jemi në një sistem parlamentar dhe unë i respektoj. Individët që kanë qejf ta marrin fjalën – e morën dhe unë e konsideroj në mënyrën ma normale diskutimin për temën që e kemi përpara.

Unë, më lejoni t'i them vetëm dy fjalë para se t'ia jap fjalën Ekipit Negociator, nëse ka të shtoj diçka. Mendoj që kjo bisedë jona e sotme e ka rolin e vet normal që e ka ky Kuvend t'i raportohet për punët e jashtëzakonshme, të rëndësisë të jashtëzakonshme që lidhen me Kosovën nga Ekipi Negociator, të cilin ky Kuvend e ka mandatuar vetë. Kjo është hera e dytë që bisedojmë brenda një muaji. Herën e parë kemi diskutuar në pika të rëndësishme të propozimit të Ahtisarit, kësaj radhe unë për vete kam pritur një raport pak më ndryshe për shembull shumë më të detajuar, çfarë dinë këta që ka hyrë në variantin final të Ahtisarit nga ato rekomandime që ka nxjerrë Kuvendi, mirëpo në fjalimet e tyre këta nuk dhanë detaje. Unë e kuptoj, sepse në fund të fundit versionin përfundimtar të Ahtisarit ashiqare që se ka në dorë askush deri sot. Unë e dëgjova një diskutim interesant, një muzikë një harmoni, sot të bukur për vesh kur bëhet substanciale do të ishte vërtetë muzikë fantastike. Zotërinj të Ekipit Negociator, nëse e kërkon fjalën, unë do t'jua jap prapë.

KRYETARI KOSOVËS FATMIR SEJDIU – PËRMBYLLJE - Të faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë dhe kolegë të mi të Ekipit të Unitetit. Unë vetëm mund të falënderoj edhe një herë për këtë mbështetje që i është dhënë këtij procesi të rëndësishëm dhe punës së përbashkët që e kemi bërë, duke ju siguruar se do të jemi në një mision këmbëngulës të realizimit të synimit tonë themelor të bërjes së Kosovës shtet sovran dhe të pavarur, të bërjes së Kosovës shtet modern të gjithë qytetarëve të saj, të bërjes së Kosovës dhe rrugëtimit të saj të nevojshëm në integrimet evropatlantike.

Është shumë e qartë se projektin final siç e thatë edhe ju z. kryesues presidenti Ahtisari do ta prezantoj sot në Këshillin e Sigurimit, bashkë me rekomandimet përcjellëse politike që do të gjendet besojmë nga ajo që ne kemi komunikuar me te dhe nga ajo që ai e ka shpalosur deri tash edhe propozimi apo formula e drejtpërdrejtë se çfarë do të jetë Kosova, cili do të jetë statusi i saj politik, prandaj ju falënderoj edhe një herë dhe shpreh gatishmërinë tonë për vazhdimin esencial të kësaj nevoje të bashkëpunimit në këtë periudhë që do të mbetet deri në momentin edhe të marrjes së vendimit të drejtpërdrejtë që ka të bëjë edhe me Këshillin e Sigurimit që ka të bëjë edhe me Kuvendin e Kosovës. Ju përsëndes.

(Duartrokitje)

KRYESUESI SABRI HAMITI- Ju faleminderit z. kryetar Seanca përfundon. Ju faleminderit.

Seanca përfundoi në orën 11,30 minuta